

Performanca e Buxhetit 2018



NË KËTË RAPORT

Periudha raportimit:

Janar - Dhjetor 2018

Statusi raportit:

Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Elbasan gjatë vitit 2018 dhe është miratuar në Këshillin Bashkiak

Përmbledhje mbi situatën financiare, të ardhurat, shpenzimet sipas programeve si edhe rezultatet kryesore të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Elbasan me asistencën e Projektit "Bashki të Forta". Për më shumë informacion na kontaktoni nëpërmjet adresës së emailit: bashkiaelbasan@elbasani.gov.al.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



Popullsia: Censuri (2011) 141.714 banorë
Rregjistri Civil 205.892 banorë

Siperfaqja: 872,03 km²

Dendësia: Censuri (2011) 162 .51banorë/km²
Rregjistri Civil 236.11 banorë/km²

Nëndarjet Administrative: 13

(1) Elbasan (2) Funar, (3) Labinot Mal, (4) Tregan, (5) Shirgjan, (6) Gjergjan, (7) Bradashesh, (8) Papër, (9) Gracen, (10) Gjinar, (11) Zavalinë, (12) Shushicë, (13) Labinot-Fushë

Rezultatet në zgjedhjet vendore të vitit 2015 si më poshtë:



Shpërndarja e anëtarëve

16 Anëtarë
13 Anëtarë
10 Anëtarë
5 Anëtarë
1 Anëtarë
1 Anëtarë
1 Anëtarë
1 Anëtarë
1 Anëtarë
1 Anëtarë
1 Anëtarë

EKZEKUTIVI

Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Elbasan për zgjedhjet vendore të vitit 2015 ishte 158.751 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 47.34%. Këshilli bashkiak përbëhet nga 51 anëtarë të grupuar midis partive politike PS, PD, LSI, PDIU dhe PR. Kryetari i Bashkisë Elbasan është Z. Qazim Sejdi.

Bashkia Elbasan është e organizuar në 5 drejtori të përgjithshme të cilat kanë në përberje drejtoritë: financa dhe buxheti; zhvillimi ekonomik, arsim dhe edukimi, shërbimet sociale, kultura dhe sporti, menaxhimi i rrugëve dhe infrastrukturës; ujë dhe kanalizime; menaxhimi i mbetjeve komunale; menaxhimi i tokës bujqësore dhe inspektimi i tregut, mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarret; shërbimet publike; administrata dhe burimet njerëzore etj.


EKONOMIA

Ekonomia e Bashkisë Elbasan mbizotërohet nga industria dhe bujqësia. Në territorin e bashkisë janë të regjistruara rreth 7615 biznese të vogla dhe 1735 biznese të mëdha. Bashkia ka si synim rritjen dhe zhvillimin e turizmit.


SITUATA FINANCIARE

- ⇒ Rritja e financimit të shërbimeve publike nga burimet e brendshme të bashkisë prej të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore pa rritur barrën fiskale.
- ⇒ Të ardhurat e veta të bashkisë zënë një peshë edhe më të madhe në burimet e bashkisë duke e rritur kontributin e tyre në tërësinë e fondeve buxhetore të bashkisë me 27%, si rrjedhojë e taksave dhe tarifave vendore në rritje (24% rritje kundrejt një viti më parë).
- ⇒ Përmirësim i menaxhimit buxhetor dhe qëndrueshmëri financiare duke kryer shpenzime buxhetore brenda burimeve të të ardhurave të mbledhura
- ⇒ Ulja e borxhit / shlyerje sipas kontratës së kredisë me bankat private dhe mos krijim detyrimesh të pashlyera me 3% kundrejt një viti më parë
- ⇒ Menaxhim i kujdesshëm i fondeve të bashkisë duke kryer shpenzime 100% në nivelin e të burimeve financiare.

Fakt 2016, 2017, 2018



2018 Vs 2017




BUXHETI 2018

Burimet e financimit planifikimi 2018

- ⇒ Transferta e pakushtëzuar (granti), në vlerën 636.618 mijë lekë;
- ⇒ Transferta specifike, e cila është në vlerën 398.045 mijë lekë;
- ⇒ Të ardhurat nga taksat dhe tarifat (plan limit), në vlerën 1.214.277 mijë lekë;
- ⇒ Të ardhura nga kredia (diferencë e pa disbursuar), në vlerën 95.658 mijë lekë;
- ⇒ Të ardhura të trashëguara nga viti 2017, në shumën 279.453 mijë lekë;
- ⇒ Transfertat e kushtëzuara në vlerën 1.995.473 mijë lekë;

Buxheti për vitin 2018 =
4.623.656 mijë lekë





Shërbimet kryesore të financuara nga bashkia janë

- ⇒ Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve; ndërtesat publike; shkolla; parqet dhe zonat rekreative, qendrat e kujdesit shëndetësor parësor; ndërtesat e administratës lokale etj.
- ⇒ Transporti publik
- ⇒ Ujë i pijshëm dhe kanalizime
- ⇒ Menaxhimi i mbeturinave komunale
- ⇒ Menaxhimi i sistemit të ujitjes dhe kulimit të mesëm dhe terciar
- ⇒ Çerdhet dhe edukimi parashkollor.
- ⇒ Mirëmbajtja e institucioneve të arsimit parauniversitar
- ⇒ Menaxhimi i kullotave dhe pyjeve komunale
- ⇒ Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi
- ⇒ Shërbimet sociale
- ⇒ Menaxhimi i varrezave publike
- ⇒ Menaxhimi i kadastrës të bujqësisë; tregjet bujqësore lokale dhe inspektimet
- ⇒ Aktivitete artistike, kulturore dhe rinore.

Buxheti i realizuar për vitin 2018 =
3.729.010 mijë lekë

TË ARDHURAT 2018




SHPENZIMET

Bashkia Elbasan i kushton vëmendje gjithnjë e më shumë në rritje në shërbimeve sociale dhe infrastrukturës.

Programet buxhetore më të financuara gjatë vitit 2018, që përbëjnë 86% të buxhetit janë:


- A. Ofrimin e shërbimeve sociale dhe banesave sociale
- B. Planifikim, Menaxhim dhe Administrim
- C. Arsimin (parashkollor dhe atë parauniversitar)
- D. Infrastrukturrën rrugore (urbane dhe rurale) dhe transportin publik
- E. Shërbime publike vendore

Shpenzime sipas programeve, % ndaj totalit të Buxhetit, 2018



Programi me realizimin më të lartë është "Përkujdesi Social" me 100% të planifikimit, ndërsa Programi "Ujësjetllës-Kanalizime" ka realizimin më të ulët me 12% të planifikimit.

Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore




SHPENZIMET

Të ndara sipas aktivitetit ekonomik, shpenzimet kapitale përbëjnë 15% të totalit të shpenzimeve kurse ato operative 85%. Vihet re një rënie e lehtë e shpenzimeve kapitale përkundrejt shpenzimeve operative gjatë vitit 2018.

Në grafik paraqitet % e realizimit ndaj planifikimit, ndërsa tabela me poshtë liston investimet më të rëndësishme të bashkisë.

Shpenzimet sipas Klasifikimit ekonomik, në Lekë



Burimi i Informacionit
"Raporti i Monitorimit 2018 - Bashkia Elbasan"


Projektet e Investimeve në Lekë

Emertimi i Projektit	Viti i fillimit ..	Viti i përfundimit ..	Buxheti	Kontraktuar	Realizimi	Progresiv nga fillimi I projek..
Mbrojtje nga perroi i Llixhësdhe zalli gostimes gjergjan	2018	2018	1,877,000		1,682,000	
Mbrojtje nga perroi i Vrushës i tokës bujqësore fshati Kryezjarr NJA Shirgjan	2018	2018	1,401,000		1,401,000	
Mbrojtje nga perroi Papërr dhe Toka bujqësore Pajun	2018	2018	2,112,000		1,890,000	
"Mbrojtje nga Perroi" Gurra Shushice", Fshati Shushice dhe Perroi"Shalthate"te tokes bujqesore, Njesia adm..	2018	2018	1,842,000		1,658,000	
Blerje automjet	2018	2018	1,596,000		1,596,000	
Blerje automjete per SHMZSH	2018	2018	19,980,000		19,980,000	
Blerje kabell ABC 2x16mmAl	2018	2018	2,998,000		0	
Blerje kazanë mbetjesh urbane	2018	2018	4,758,000		4,758,000	
Blerje Komputera 40 cope, ekran22" flat LED 5 cope, printera 10 cope, fotokopje, pajisje komp. etj.	2018	2018	3,730,000		0	
Blerje makina pastrimi	2018	2018	5,700,000		0	
Blerje ndriçues me krahë	2018	2018	2,296,000		0	
Investime te tjera	2018	2018	15,586,000		7,491,000	
Mbrojtje nga perroi i Muçanit të tokës bujqësore fshati Muçan njesia Administrative Tregan	2018	2018	912,000		843,000	
Mbrojtje nga "Perroi i Kushes" te tokes bujqesore fshati Karakullak ,Njesia administrative Bradashesh	2018	2018	1,112,000		723,000	
Ndertim kuz ne rruget " Qamil Lopari", Lagja " Skenderbej"	2018	2019	17,280,000		0	
Ndertimi i nje ambulance ne fshatin Mamel, tip A1, Nesia Administrative Gracen	2018	2018	942,000		0	
Ndriçim i qendrave te NJA Bashkia EL	2018	2018	2,567,000		0	
Pajisja me kamera sigurije të objekteve arsimore dhe institucioneve	2018	2018	131,768,000		0	
Projekt zbatimi per rikalifikimin urban te Teatrit "Skampa"	2018	2019	4,803,000		0	
Rehabilitimi I rruges Komunale Qender-Shushice-Lagja e vjeter Shushice	2018	2018	1,759,000		0	
Rikonstruksion i kanalit ujites kryesor (Ferras + Harvaleas) dhe rikonstruksion kanali ujites Kv2 Funar ne njesi..	2018	2018	1,719,000		1,435,000	
Rikonstruksion I nje ambulance ne fshatin Fushe-Buall, Njesia Administrative Shushice.	2018	2018	1,305,000		0	
Rikonstruksion i rruges " Aleks Vini" (te zjarrfikjsja)	2018	2018	11,788,000		10,066,000	
Rikonstruksion I rruges " Caush Asllani " + " Ismail "Xhemali Debrova"	2018	2018	40,393,000		18,207,000	
Rikonstruksion I rruges "Besim Levonja" (nga kisha shen thanasi" deri te "Ara e Prasit")	2018	2018	12,560,000		7,156,000	
Rikonstruksion i rruges "Fetah Ekmeçiu" + rruges "Apostol Gega"	2018	2018	25,323,000		21,804,000	
Rikonstruksion I shkolles 9-vjecare "Bardhyl Popa" bashkfinancim me fzhr kontrib.30%	2018	2019	19,438,000		0	
Rikonstruksion i vazhdimit te rruges" Rinia" + rruga "Ekrem Halili "+ rruga " Abdyl Graceni"	2018	2018	25,859,000		13,823,000	
Rikonstruksion I zyrove per Rajonet nr.1 dhe nr.2	2018	2018	4,565,000		0	
Shpronosime sipas VKM (kredi)	2018	2018	0		1,180,000	
Sifon I kanalit ujites Vreshtan-Shushice	2018	2018	5,218,000		5,074,000	
Sistemim asfaltim rruga "Sami Baholli",Lagj. "Visarion Xhuvani"prane pall.464 (kredi)	2018	2018	2,622,000		1,809,000	
Vendosje kangjellash(gardreil) ne kryezqimet e rrugëve kryesore te qytetit	2018	2018	2,718,000		2,715,000	
Vendosje rrethimi metalik I vendgrumbullimit te plehrave ne rrugët kryesore te qytetit	2018	2018	2,352,000		2,283,000	

Burimi i Informacionit
"Raporti i Monitorimit 2018 - Bashkia Elbasan"

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Rezultatet vjetore të treguesve të performancës buxhetore



Bashkia ka rritur performancën e përdorimit të fondeve buxhetore. Kjo rritje ka ardhur edhe në sajë të rritjes së transparencës së vendimarrjes bashkiake.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak kanë qenë të hapura dhe mbi 75% e vendimeve që detyrojnë konsultimin me publikun janë diskutuar paraprakisht me banorët.

Disa arritje të rëndësishme të përmirësimit të shërbimeve ofruar komunitetit vendor falë rritjes jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të kapaciteteve njerëzore të bashkisë janë renditur më poshtë nëpërmjet treguesve të performancës sipas programeve.

PROGRAMI

PLANIFIKIMI MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivi i programit

Përmirësimi i Burimeve
Njerëzore të Bashkisë

Realizimi i shpenzimeve :

*100% e vlerës së
parashikuar (438.969 mijë
lekë, 12% e buxhetit)*

TREGUES PERFORMANCE:

Bashkia ka arritur objektivin si rrjedhojë e përmirësimit të të gjithë treguesve të performancës së këtij programi buxhetor si:


♦ **TP 1. Rritja e qëndrueshmërisë së administratës civile**

1.421 punonjës të punësuar në njësi administrative të ndryshme; Vetëm 21 nga 1.421 punonjës në total kanë lëvizur nga puna gjatë vitit 2018 (1% e stafit);

♦ **TP2. Përmirësimi i punës së stafit të bashkisë**

Janë marrë vetëm 2 masa disiplinore për punonjësit e bashkisë gjatë vitit 2018 (nga 3 një vit më parë) pasi rezultatet e auditimit të bashkisë si nga KLSH ashtu edhe nga kontrolli i brendshëm i bashkisë janë shumë të mira.

♦ **TP3. Rritja e kapaciteteve / burimeve njerëzore të bashkisë**



PROGRAM

ÇËSHTJE FINACIARE DHE FISKALE

Objektivi i programit

Përmirësimi i financave të bashkisë

Realizimi i shpenzimeve :

88% e vlerës së parashikuar (70.109 mijë lekë, 2% e buxhetit)



TREGUES PERFORMANCE:

Bashkia ka arritur objektivin si rrjedhojë e përmirësimit të të gjithë treguesve të performancës së këtij programi buxhetor:

♦ **TP 1. Bashkia nuk krijon defiçit**

Bashkia nuk ka krijuar deficit buxhetor duke kryer shpenzime brenda mundësive financiare të grumbulluara gjatë vitit 2018.

♦ **TP 2. Përmirësimi i mbledhjes të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore (**

Bashkia ka gati dyshifuar të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, falë një menaxhimi të shkëlqyer nga administrata e taksave vendore pa rritur barrën fiskale për komunitetin.

♦ **TP 3. Rritja e të ardhurave të tjera të bashkisë**

Bashkia nuk ka mundur të administrojë të ardhurat nga asetet dhe ndihmat ashtu sikurse kishte planifikuar. Kjo për arsye se të ardhurat nga asetet nuk u mundën për shkak të investimeve në asete sipas planifikimit.

PROGRAMI

MENAXHIMI SISTEMIT TË VADITJES DHE KULLIMIT



Objektiva- Rritja e prodhimit bujqësor
 Bashkia ka përmirësuar ndjeshëm situatën për familjet fermere dhe biznesin bujqësor duke përmirësuar infrastrukturën e vaditjes dhe kullimit (42.236 mijë lekë) të shpenzuar, 52% e planifikimit)

TREGUES PERFORMANCE

Të gjithë treguesve të performancës së këtij programi buxhetor janë përmirësuar si:

TP 1. Përmirësimi i shërbimit

-Rritja e sipërfaqes bujqësore e mbuluar me ujitje (trendi në %)

-Rritja e sipërfaqes bujqësore së mbuluar me kullim (trendi në %)



Bashkia ka rritur me 10% sipërfaqen bujqësore të mbuluar me vaditje dhe 3% mbuluar me kullim kundrejt një viti më parë. Nga 1,600 ha në 2015 në 3,300 në 2018

TP 2. Përmirësimi i sistemit

-Përmirësimi i rrjetit të kullimit të pastruar apo shtuar (në % kundrejt rrjetit total)

-Përmirësimi i rrjetit të vaditjes të pastruar apo shtuar (% kundrejt rrjetit total)

Bashkia krahasimisht me sesi e gjeti këtë shërbim në fillim të vitit 2016 kur e mori nga Ministria e Bujqësisë ka trefishuar shërbimin e saj për familjet fermere. Një pjesë e madhe e kanaleve vaditëse dhe kulluese nuk ishin pastruar për më shumë se 10 vite. Synimi është që në dy vitet e ardhme të pastrohet gjithë sistemi.



PROGRAMI

ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Objektiva- Rritja e produkteve nga pyjet dhe kullotat

Bashkia ka arritur objektivin si rrjedhojë e përmirësimit të të gjithë treguesve të performancës së këtij programi buxhetor. Bashkia trashëgoi në vitin 2016 një fond pyjor prej 52,327 ha pyje dhe kullota duke shtuar numrin e pemëve të mbjella në vit. Ku vetëm në vitin 2018 bashkia ka mbjellë mbi 14 mijë pemë (disa herë më shumë sesa viti 2015) bashkia e ka cuar fondin pyjor në 52,727 ha në fund të vitit 2018).

TREGUES PERFORMANCE

♦ TP1. Planet e menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor

Bashkia ka rritur numrin e pemëve me rreth 2.500 të tilla

♦ TP2. Rritja e inspektimit të fondit pyjor dhe kullosor

Numri i inspektimeve gjatë vitit është rritur me rreth 296 të tilla

♦ TP3. Rritja e monitorimit të fondit pyjor dhe kullosor


Bashkia ka 18 punëtorë që mbulojnë monitorimin e pyjeve dhe kullotave

♦ TP4. Efiçienca e përdorimit të buxhetit të alokuar për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor

Bashkia shpenzon 348 lekë/ha tokë pyje dhe kullota dhe synon rritjen e saj në rreth 1.048 lekë/ha në vitin 2019.

♦ TP5. Përmirësimi i fondit pyjor dhe kullosor

Bashkia ka shpenzuar rreth 0.5% të buxhetit, (18 mln lekë) për Administrimin e pyjeve dhe kullotave për vitin 2018 dhe synon trefishimin e këtij fondi deri në fund të vitit 2022.




PROGRAMI

MENAXHIMI MBETJEVE BASHKIAKE

Objektiva: Përmirësimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane

- ⇒ *Bashkia ka përmirësuar dukshëm këtë shërbim falë mbylljes së vend-depozitimit aktual të mbetjeve bashkiake dhe fillimit të punës të impiantit rajonal të menaxhimit të mbetjeve. Për rrjedhojë bashkia arrin të mbulojë më shumë sesa 100 koston operative të këtij shërbimi nga tarifat e mbledhura.*
- ⇒ *Duke qenë se bashkia tashmë me një territor të zgjeruar duhet të ofrojë shërbim edhe në pjesën rurale të saj mbulon një sipërfaqe pak më të vogël sesa ajo e bashkisë së vjetër / vetëm urbane. Për rrjedhojë bashkia e ofron shërbimin mbi 70% të territorit.*



Tregues Performance

- ◆ **TP1.** % e popullatës e mbuluar me shërbim
- ◆ **TP 2.** % e sipërfaqes së territorit e mbuluar me shërbim
- ◆ **TP 3.** % koston së shërbimit e mbuluar nga tarifa

Kosto mesatare e një ton mbetje është rreth 2,200 Lekë

PROGRAMI

PJESËMARRJE AKTIVE TË QYTETARËVE NË VENDIMARRJE

Objektiva: Rritja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimarrje


- ⇒ *Bashkia Elbasan është e hapur ku konsultimin me komunitetin e konsideron çelës për një vendimarrje sa me të drejtë.*
- ⇒ *Gjatë vitit 2018 bashkia ka realizuar 24 konsultime me publikun për çështje të ndryshme, duke reflektuar edhe respektimin e detyrimit ligjor.*
- ⇒ *Të gjitha mbledhjet e KB janë kryer me dyer të hapura (publiku ka pasur mundësinë të jetë prezent në to). KB ka marrë 162 vendime gjatë këtij viti ndërkohë që 32 prej të cilave janë konsultuar paraprakisht me publikun (qoftë nga administrata e bashkisë qoftë nga vetë KB).*



Tregues Performance

TP 1. Vendimarrje bashkiake e konsultuar me publikun (Numri i konsultimeve të realizuara kundrejt totalit të vendimeve për të cilat konsultimi parashikohet me ligj (në %))

TP 2. Numrit total i mbledhjeve të KB të hapura për qytetarët kundrejt numrit total të mbledhjeve bashkiake (në %)




PROGRAMI

SHËRBIMI I UJIT TË PIJSHËM DHE KANALIZIMET


Objektiva:

A. Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ujit të pijshëm

- ⇒ *Bashkia mbulon më shumë se 80% të popullatës me shërbimin e ujit të pijshëm dhe mbi 60% të popullatës me kanalizime sanitare.*
- ⇒ *Bashkia përpara reformës territoriale mbulonte 10% popullatën me këtë shërbim.*
- ⇒ *Falë një administrimi më të mirë të të ardhurave nga tarifat dhe uljes së humbjeve bashkia pothuajse mbulon koston operative të shërbimit dhe rreth 70% të koston totale të shërbimit duke ofruar 13 orë ujë të pijshëm në ditë - natë.*



Performanca e shërbimit ujë i pijshëm dhe kanalizime 2015-2018



Tregues Performance

TP1. Popullata e mbuluar me ujë të pijshëm (%)

TP 2. Popullata e mbuluar me kanalizime sanitare (%)

TP 3. Norma e mbulimit të koston së shërbimit të ujit të pijshëm nga tarifa

TP 4. Norma e mbulimit të koston së shërbimit të kanalizimeve nga tarifa

TP 5. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë të pijshëm (orë në ditë)

PROGRAMI

MBËSHTETJA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Objektiva: Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik vendor


Falë përmirësimit të infrastrukturës rrugore, sigurisë, marrëdhënieve më të mira me biznesin bashkia ka përmirësuar në përgjithësi klimën në bashki. Për rrjedhojë të ardhurat nga biznesi vendor që ushtron aktivitetin brenda territorit të bashkisë janë rritur.

Bashkia ka investuar në vitin 2018 për të mbështetur bizneset e vogla që merren me aktivitetin e shtijes së produkteve bujqësore, duke e dyfishuar numrin e tregjeve vendore nga 4 në vitin 2015 në 8 në vitin 2018 dhe duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën e tyre.

Realizimi i shpenzimeve : 94%
e vlerës së parashikuar
(1.211 mijë lekë)

Tregues Performance

- ◆ **TP 1.** Rritja e kapaciteteve ekonomike përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë (rritja e investimeve në %)
- ◆ **TP 2.** Rritja e të ardhurave nga bizneset vendore / që ushtron aktivitet brenda territorit të bashkisë (Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin përkundrejt vitit të kaluar - rritja në %)



PROGRAMI

SHËRBIMET BUJQËSORE, INSPEKTIMI, SIGURIA USHQIMORE DHE MBROJTJA KONSUMAT

Objektivi: Bashkia mbështet prodhimin bujqësor nëpërmjet inspektimit

Prodhimi bujqësor nuk mund të varet vetëm nga prodhimi i familjeve fermere me një sipërfaqe të kushtëzuar dhe mjete modeste prodhimi.

Nxitja e prodhimit bujqësor nëpërmjet ndërmarrjeve bujqësore është e mundur duke lehtësuar regjistrimin e pronës bujqësore dhe shpërndarjen / lëshimin e titujve të pronësisë.

Gjatë vitit 2018 bashkia ka dhënë 3,443 certifikata dhe synon të arrijë në 4,244 certifikata të tokës bujqësore në vitin 2019 ose 19% më shumë sesa një vit më parë. Kjo gjë do ti hapë rrugën bizneseve që mund të hapen në territorin e bashkisë tonë.

Tregues Performance

- ◆ **TP 1.** Numri i certifikatave të pronës bujqësore të regjistruara (rritja ne %)



PROGRAMI

TRANSPORTI PUBLIK

Objektiva: Sigurimi i transportit publik për komunitetin



Nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës rrugore kruesisht asaj rurale por edhe asaj urbane ku nga vetëm 90 km rrugë rurale të trashëguara në vitin 2016 janë të përdorshme 144 km dhe shtuar vetëm në vitin 2018 rrugë urbane të reja 3 km (gjithsej tani 38 km) është rritur ndjeshëm transporti publik, për rrjedhojë të gjithë treguesit e transportit publik janë

Është disafishuar numri i mjeteve dhe numri i linjave të transportit publik. Në fund të vitit 2018 numërohen 131 mjete të transportit publik në total nga të cilat 117 për transportin interurban dhe 24 për atë brenda qytetit. Dhe 53 linja nga vetëm 14 që ishin në vitin 2015. Kjo ka bërë edhe që numri i bileta të transportit publik të rritet.

*Realizimi i shpenzimeve :
95.2% e vlerës së parashikuar
(40.752 mijë lekë)*

Tregues Performance

- ♦ **TP 1.** Numri i linjave të transportit publik urban dhe interurban (rritja vjetore në %)
 - rritja vjetore e linjave interurbane
 - rritja vjetore e linjave urbane
- ♦ **TP 2.** Numri i mjeteve të transportit publik (urban dhe interurban) rritja vjetore në %
 - rritja vjetore e mjeteve interurbane
 - rritja vjetore e mjeteve urbane



PROGRAMI

SHËRBIME PUBLIKE VENDORE

Objektiva: Bashkia mbështet zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike

Shërbimet publike që financohen nga ky program janë sipërfaqet e gjelbëra dhe hapësirat rikrijuese, trotuaret dhe menaxhimi i varrezave publike.


Vetëm gjatë vitit 2018 bashkia ka shtuar me 123 mijë km² sipërfaqen e gjelbëruar publike duke e çuar sipërfaqen totale të bashkisë në rreth 353 mijë km² sipërfaqe e gjelbër publike.

Vetëm rrënjë të reja pemësh të shturara janë 1875 duke e çuar fondin e bimëve dekorative të këtyre hapësirave në 12 mijë rrënjë gjithsej.

Gjatësia e trotuareve ka arritur në rreth 264 km linear shtuar vetëm në vitin 2018 me rreth 70 km ose rreth 36% kundrejt asaj çfarë ishte në inventarin e bashkisë në fund të vitit 2017.

Tregues Performance

- ♦ **TP 1.** Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)
- ♦ **TP 2.** Rrënjë pemë të mbjella kundrejt totalit të pemëve për të cilat kujdeset / fondi i pemëve të bashkisë (në %)
- ♦ **TP 3.** Total km linear trotuar kundrejt vitit të kaluar (ndryshimi në %)
- ♦ **TP 4.** Rritja e efijencës buxhetore në ofrimin e shërbimit të gjelbërimit (Lekë të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifatat vendore (në %))



PROGRAMI

STREHIMI SOCIAL

Objektiva: Bashkia siguron strehim social për kategoritë në nevojë

*Realizimi i shpenzimeve : 93%
e vlerës së parashikuar, me
disa fish rritje të investimeve*

Gjatë vitit 2018 bashkia ka mbështetur 30 familje me banesa sociale ndërkohë që me përfundimin e projekteve të investimit të bashkisë në këtë fushë pritet të arrijë ky numër në 100 të tilla në fund të tre viteve të ardhshme.



Tregues Performance

- ♦ **TP 1.** Numri personave të mbështetur me strehim social

Numri i familjeve që përfitojnë bonus strehimi, (merren para kesh për një kontratë qeraje)

- ♦ **TP 2.** Rritja e të ardhurave nga shërbimi i banesave sociale të bashkisë (Të ardhurat nga qeraja e banesave sociale në %)

Numri i familjeve që përfitojnë bonus strehime, (merren para kesh për një kontratë qeraje)



PROGRAMI

MBROJTJA NGA ZJARRI DHE EMERGJENCAT CIVILE

Objektivi

Përmirësimi i shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

Tregues Performance

TP 1. Rritja e eficiencës së MZSH (në % kundrejt planit)

Bashkia ka marrë funksionin në vitin 2016 nga Ministria e Punëve të Brendshme. Asetet e trashëguara dhe numri i punonjësve ka qenë i pamjaftueshëm për të ofruar një shërbim normal për komunitetin si edhe për ti ardhur në ndihmë bashkive fqinje.

Për rrjedhojë Bashkia Elbasan ka blerë 5 makina zjarrfikëse, në këtë mënyrë i është përgjigjur më shpejt qytetarëve në rast nevoje.

Bashkia ka rritur inspektimet për të parandaluar rastet e rreziqeve të mundshme. Mjetet e vjetra të trashëguara nga Qeveria Qendrore ia ka falur Bashkive fqinje.

